



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.88/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glligjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Ferizaj për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, kështu që koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Ferizaj i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,600.00 (tremijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 në rrugën kryesore të qytetit Dëshmorët e Kombit në Ferizaj, monitoruesi i tyre ka hasur në poster nga koalicioni PDK-AAK-NISMA etj. të ngjitur në drunjë të qytetit dhe në shtylla publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së Nr.03/L-073. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën nr.11/2013, neni 4.1, (b). Përkundër kësaj koalicioni ka ndërmarr masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar. Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatëve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit

PDK-AAK-NISMA janë vendosur në drunjë dhe shtylla publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA janë vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe faktin për kundër të këtij fakti se posteret e kandidatëve për deputet nga ky koalicion janë vendosur në drunjë dhe shtylla publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterët në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.88/2017 më datën 07.06.2017.



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.